



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/41/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka inicuar procedurë disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarit L.Xh për shkak të dyshimit të arsyeshëm për shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.8 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 7 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 16.12.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet rasti i inicuar sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarit L.Xh i datës 18.11.2022, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 24.10.2022 në emisionin “Kallxo Përnime” me titullin “B. e. K”, në mes tjerash është përmendur se, në lëndën PPP.nr.737/18 ka pasur komunikim ex parte ndërmjet gjyqtarit L.Xh dhe kreditorit S.D, në të cilin emision është deklaruar edhe gjyqtari L.Xh.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 18.11.2022 ka inicuar sipas detyrës zyrtare hetimet preliminare disiplinore ndaj gjyqtarit L.Xh për të vlerësuar se a ka bazë për inicim të procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 18.11.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për inicimin e hetimeve preliminare disiplinore ndaj gjyqtarit L.Xh.

Me datë 18.11.2022 Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka kërkuar nga gjyqtari që të deklarohet lidhur me pretendimet se ka pasur komunikim ex parte me kreditorin S.D,

Me datë 22.11.2022 gjyqtari L.Xh ka dhënë deklaratë në të cilën ka theksuar se, me kreditorin S.D, përveç takimeve dhe komunikimeve në seanca gjyqësore me prezencë edhe të palës kundërshtarë, ka pasë edhe një komunikim të pa dëshiruar në zyrën 212 objekti A të gjykatës, ku punon si gjyqtar. Ka shtuar se, kreditori D., disa ditë pasi që ka përfunduar shqyrtimi kryesor lidhur me çështjen e cekur përmbartimore dhe pas marrjes e draftimit të vendimit, i ka ardhur në zyre në mënyrë të papritur. Ka theksuar se, palën S.D nuk e ka ftuar ai dhe askush nga zyra tij për t’u takuar, pasi që në çështjen ku i njëjti ishte palë me cilësi të kreditorit shqyrtimi veç kishte

përfunduar. Ka shtuar se, i njëjti thjesht pasi që kishte hyrë në ndërtesë ka shfrytëzuar rastin kur nuk ka qenë prezent askush tjetër në zyre e as zyrtarja ligjore dhe ka hy në zyrë pa trokitur. Tutje gjyqtari ka theksuar se, pasi ka hyrë pala në zyre, së pari e ka pyetur si ke hy në ndërtesë pa të thirrë? Ndërsa pala i ka thënë se “ka pasë seancë tjetër dhe ka shfrytëzuar rastin e ka ardhë deri këtu”, ndërsa pala ka filluar të flet për vetën e tij, ndërsa ai si gjyqtar i ka thënë se tani do ta thërret Sigurimin për këtë hyrje ta pa ftuar, ndërsa i njëjti në nguti duke dalë nga zyra ka thënë se: “Nëse e humbi këtë rast do të hyjë në burg ose do të jem i vdekur”.

Tutje në deklaratën e tij gjyqtari ka theksuar se, nuk e konsideron takim Ex Parte, nuk është biseduar tjetër për çështjen përveç sa u përshkrua më lartë, andaj edhe nuk ka konsideruar të nevojshme të mbajë shënim zyrtar, pasi që vendimi veçse ishte përgatitur për ekspedim. Ka shtuar se, kësi raste të hyrjeve pa ftesa ka pasur edhe nga palë tjera dhe në raste tjera dhe është i bindur se kanë pasur çdo njëri nga gjyqtarët civilist, por që vetëm në raste më të rënda dhe kur procedura ishte duke u zhvilluar ka bërë shënime zyrtare.

Në deklaratën e tij gjyqtari ka shtuar se, për H.D ka pasur njohuri se është Prokuror në Apel, kurse si person e ka njohur shumë vonë, pak kohë para se i njëjti të shkoj në pension, nuk ka pas shoqëri me të dhe as ndonjë afërsi kolegiale. Ka theksuar se, deri sa ka qenë duke punuar në prokurori, edhe ka mundur të pi ndonjë kafe të mëngjesit me kolegë të tjerë dhe në shoqëri të tij, në bufenë e pallatit, por që asnjëherë nuk kanë biseduar për ndonjë lëndë apo në mënyrë specifike për lëndën e rastit, ndërsa nga koha kur i njëjtit është larguar nga puna në Sistemin e Drejtësisë, jo vetëm që nuk ka pi kafe me të njëjtin por as që është takuar ndonjë herë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe deklarimit të gjyqtarit, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit L.Xh.

Rrjedhimisht, Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarit L.Xh lidhur me lëndën përmbartimore PPP.nr.737/18 të cilat janë inicuar sipas detyrës zyrtare.

Nga shkresat e lëndës PPP.nr.737/18 rezulton se, kreditori N.P.N “Ç...” me pronar S.D me datë 06.06.2018 ka parashtruar propozim për përmbartim të përmbartuesi privat, përmbartuesi privat me datë 06.06.2018 ka caktuar urdhërin përmbartimor me të cilin e ka aprovuar propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave. Pas mbajtjes së seancave gjyqësore, Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e datës 24.07.2020 ka aprovuar prapësimin e debitorit “E...” sh.p.k dhe ka anuluar Urdhërin për Përmbartim P.nr,695/18 i datës 06.06.2018, dhe i njëjti aktvendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.4662/20 të datës 25.05.2021.

Nga deklaratat e gjyqtarit L.Xh rezulton se është e vërtet se kreditori S.D ka shkuar në zyrën e gjyqtarit, por pa ftesë dhe pa e kontaktuar më parë gjyqtarin, dhe se i njëjti ka shkuar në zyrën e gjyqtarit pasi ka përfunduar seanca e shqyrtimit kryesor dhe aktvendimi ka qenë në proces të draftimit dhe ekspeditimit, e jo gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në këtë çështje, dhe pasi kreditori ka tentuar të bisedoj me gjyqtarin lidhur me lëndën, i njëjti e ka larguar nga zyra duke dashur ta thërras Sigurimin e gjykatës, por kreditori është larguar nga zyra e gjyqtarit, dhe për këtë Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret nuk mund të konsiderohet si takim i pahijshëm ex parte ndërmjet gjyqtarit dhe kreditorit, pasi që këtu nuk pa pas vullnet e as qëllim për takim, përkundrazi gjyqtari ka qenë në zyrën e tij ndërsa kreditori ka shfrytëzuar mundësinë që ka qenë brenda pallatit dhe ka tentuar të flas më gjyqtarin e çështjes.

Për më tepër, Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se në rastet ku palët në procedurë tentojnë të bisedojnë me gjyqtarin gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore pa prezencën edhe të palës tjetër është e domosdoshme të përpilohet shënim zyrtar dhe të njoftohen palët dhe Kryetari i Gjykatës, po në rastin konkret takimi ndërmjet gjyqtarit dhe kreditorit është bërë pasi është marrë aktvendimi dhe i njëjti ka qenë në fazën e ekspeditimit të vendimit, po ashtu gjyqtari i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për t'iu shmangur takimit të padëshiruar duke e larguar palën nga zyra dhe duke e paralajmëruar se për këtë hyrje në zyre pa ftesë do ta njoftoj sigurimin e gjykatës pas të cilave veprime të gjyqtarit, kreditori D., është larguar nga gjykata.

Nën dritën e rrethanave të rastit, duke i pasur parasysh veprimet e ndërmarra dhe provat e grumbulluara në fazën hetimeve preliminare të inicuar sipas detyrës zyrtare, rezultoi se në veprimet e gjyqtarit L.Xh nuk ka shkelje disiplinore të parashikuar me nenin 5 par.2 pika 2.8 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me procedurën e inicuar sipas detyrës zyrtare, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 2, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/41/22, me datë 16.12.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë